

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Tonka Berishaj kryetare, Fillim Skoro gjyqtar referues e Have Haliti anëtare në çështjen penale e të akuzuarve K.B. për veprën penale mbajtja në pronësi kontrolle apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, B.SH., A.B, E.L., J.B., A.K., B.H., dhe J.H., për shkak të veprës penale secili veç e veç Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së, si dhe B.H. edhe për veprën penale Mbajtja ne pronësi kontrolle apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, për të vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve B.SH. av. G.H., A.B., a.v. A.S., E.L. av. N.H., J.B. av. A.I., A.K. av. A.GJ., B.H. av. B.SH., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë PKR. nr.264/15 të dt.17.07.2018, në seancën publike te kolegjit të mbajtur me dt.17.01.2019 mori këtë:

AKTGJYKIM

I. Me aprovimin e pjeserishëm te ankesës të PRSK-së, si dhe me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve B.H., A.B., dhe J.B., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore DKR në Prishtinë PKR nr.246/15 të dt.17.07.2018, përkitazi me vendimin mbi dënimin dhe Gjykata e Apelit të akuzuarve E.L., për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe Terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, për te cilën vepër është shpallur fajtorë, Gjykata e Apelit ia shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6(gjashtë) muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me dt. 09.01.2015, të akuzuarit A.K. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, për te cilën vepër penale është shpallur fajtorë, ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6(gjashtë) muaj, e në te cilin dënim, do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 01.10.2014 deri me dt 15.07.2015, në arrest shtëpiak prej dt. 15.07.2015 deri me dt. 13.03.2016 si dhe paraburgimi prej dt. 30.05.2016 deri me dt.17.07.2018, të akuzuarit B.H. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, për te cilën vepër është shpallur fajtorë ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy) vite, dhe për veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontrolle, apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par .1 të KPRK, për te cilën vepër penale është shpallur fajtorë, dënimin e shqiptuar me burgim ne kohëzgjatje pre 6 (gjashtë) muajve e merr si të vërtetuar, dhe për dy vepra penale, në bazë te nenit 80 par. 2 nën par 2.2 të KPP-së ia shqipton dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pesë) muaj, e në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe ne arrest shtëpiak prej dt. 18.08.2014 deri me dt. 02 .11.2015, të akuzuarit A.B. dhe J.B. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, për te cilat vepra penale janë shpallur fajtorë, secilit veç e veç ia shqipton dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej nga 2(dy) vite, e në të cilat dënime të akuzuarve do te iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me dt. 09 .01.2015.

II. Refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.SH. av. G.H., E.L. av. N.H. dhe A.K. av . A.GJ..

III. Ne pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa prekur.

Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë , PKR.nr.264/15, të dt. 17.07.2018, të akuzuarit K.B., B.SH., A.B., E.L., J.B., A.K., dhe B.H. janë shpallur fajtorë për veprën penale secili veç e veç në Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së, ndërsa B.H. dhe K.B. edhe për veprën penale mbajtja ne posedim pronësi kontrolle apo shfrytëzim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par.1, të akuzuarin K.B. gjykata ia ka shqiptuar dënimin ne kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet në afat prej 1(një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, në qoftë se gjate kësaj kohe nuk kryen vepër tjetër penale gjatë afatit te verifikimit kohorë, atëherë dënimi me burgim me kusht ka për te iu revokuar me dënim me burgim, në te cilin do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me 20.04.2015, të akuzuarit B.SH. ia ka shqiptuar dënimin në kohëzgjatje prej 2(dy) vjet e 4(katër) muaj, në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 11.08.2014 deri me dt.01.12.2014, i akuzuari A.B. është dënuar në kohëzgjatje prej 2(dy) vjet e 4 (katër) muajve, në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim nga dt.11.08.2014 deri me 05.06.2015 dhe në arrest shtëpiak prej 05.06.2015 deri me 15.11.2016, i akuzuari E.L. është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 3(tri) vjet, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me 09.01.2015, i akuzuari J.B. është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2(dy) vjet e 4(katër) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt.11.08.2014 deri me dt.09.01.2015, i akuzuari A.K. është dënuar me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 4(katër) vjet në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 01.10.2014 deri me dt. 15.07.2015, në arrest shtëpiak prej dt. 15.07.2015 deri me dt. 13.03.2016 si dhe koha e kaluar në ri caktim të paraburgimit prej 30.05.2016 deri me 17.07.2018, të akuzuarit B.H. gjykata ia ka përcaktuar për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe terroriste nga neni 143 par.2 dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 8(tetë) muaj dhe për veprën penale Mbajtja ne pronësi kontrolle posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve dhe ia ka shqiptuar dënimin unik me burgim ne kohëzgjatje 3(tri) vjet, në te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me 20.04.2015 dhe arrest shtëpiak nga 20.04.2015 deri me dt.02. 11.2015.

Konform nenit 69 të KPRK dhe nenit 374 par 3 të KPRK, iu janë KONFISKUAR përgjithmonë:

Nga i akuzuari K.B. një revole e tipit "TT" prodhim jugosllav me nr. serik. C-1492 kal.7.62 x 25 mm, të sekuestruara në banesën e tij ne lagjen " Emshir"

Nga i akuzuari B.H. janë konfiskuar dy pushkë automatike AK -47 me numra serik 554407 dhe 27970, një pushkë gjysmë automatike me numër serik 056944-88, katër karikatorë, municion te llojeve të ndryshme, një uniformë ushtarake dhe një maskë gazi.

Secili nga të akuzuarit është i obliguar ti paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësore secili ne shumë prej nga 100 (njëqind) euro, në afat jo me të gjatë se tre muaj nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I akuzuari J.H. në bazë te nenit 364 par .1 nën par. 1.3 të KPP lirohet nga akuza.

Kundër këtij aktgjykimi në afat kanë paraqitur ankesë:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes se ligjit penal sipas nenit 383 par. 1 nën par. 1.2 të KPRK, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë te gjendjes faktike,

të vendimit lidhur me sanksionin penal, dhe propozon që të aprovohet ne tërësi ankesa dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të njëjtit të dënohen me një dënim me të rendë, ndërsa për te akuzuarin J.H. ta shpall fajtor për veprën penale nga neni 143 par .2 me propozim që aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe qështja penale të kthehet ne rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.SH. av. G.H. për shkak të shkeljeve esenciale, shkeljes se ligjit penal, vërtetimit te gabueshëm ose jo të plotë te gjendjes faktike, dhe për shkak te vendimit lidhur me sanksionin penal me propozimin që ankesën ta aprovojë si te bazuar duke e liruar të pandehurin nga akuza dhe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B. av . A.S. për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale me propozim që Gjykata e Apelit të pandehurit të ia zbusë dënimin e shqiptuar.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.L. av . N.H. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë te gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal, dhe vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshojë aktgjykimin dhe të akuzuarin E. ta lirojë nga akuza apo që aktgjykimin ta kthejë ne rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.B. av. A.I. për shkak të vendimit mbi sanksionin penal nga neni 387 par. 1 dhe 2 të KPRK-së me propozim që të aprovohet anesa si e bazuar dhe gjykata ta ndryshojë aktgjykimin dhe të akuzuarit të ia shqiptojë një dënim me të butë dhe me të lehtë nen minimumin e përcaktuar për veprën e cekur penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K. av. A.GJ. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave te procedurës penale, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë te gjendjes faktike, zbatimit të gabueshëm të se drejtës materiale dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarin A.ta liroj nga akuza dhe aktgjykimin e ankimuar ta kthej ne rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H. av. B.SH. për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale, vërtetimit të gabuar ose jo të plotë te gjendjes faktike, shkeljes se ligjit penal dhe vendimit të sanksionit penal me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin B. ta liroj nga akuza.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.555/18 të dt. 13.12.2018 duke u sqaruar përkritazi me ankesat e PRSK dhe mbrojtëses së të akuzuarit, ka propozuar që ankesa e PRSK të aprovohet, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptohen dënime më të rënda, ndërsa për te akuzuarin J.H. aktgjykimi të anulohet dhe qështja të kthehet në rigjykim dhe vendim.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë të akuzuarit B.SH., E.L., B.H., si dhe mbrojtësit e të akuzuarve av. A.I., av.A.SH. me autorizim zëvendësues, av. A.GJ., av. N.H., av. A.S. dhe av. G.H., ndërsa në seancë nuk morën pjesë Prokurori i Apelit, të akuzuarit K.B., A.B., J.B. dhe A.K. si dhe mbrojtësi i të akuzuarit B.H. av. B.SH. edhe pse kanë qenë te njoftuar në mënyre te rregullt.

Gjykata e Apelit, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PRSK dhe të mbrojtëses së të akuzuarve B.SH., A.B., E.L., J.B., A.K., dhe B.H. e duke marrë parasysh, edhe sqarimin me shkrim të Prokurorit të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, e pas shqyrtimit dhe vlerësimit edhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesat e PRSK është pjesërisht e bazuar ndërsa ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.H., A.B. dhe J.B. janë të bazuara.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në ankesën e saj pretendon se është shkelur ligji penal sipas nenit 383 par 1. nën par 1.2 të KPRK ku gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike kur gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqiptuar një dënim adekuat krahasuar me peshën e veprës penale, e me këtë rast e ka bërë edhe shkeljen e ligjit penal ku nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjësive penale të akuzuarve, sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore ka pasur dyshim të bazuar se të akuzuarit e lartë cekur janë përfshirë për shkak të veprës penale secili veç e veç Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste, sipas Prokurorisë Speciale është dashur që në aktgjykimin e marrë, të përmbaje edhe arsyetimin e ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës për të cilin aktakuzë është përfshirë edhe i akuzuari J.H., i cili po ashtu ka kryer të njëjtën vepër penale, ku është liruar nga dënimi, pra me këtë rast gjykata e shkallës së parë e ka bërë vërtetimin e gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike pasi që e ka liruar të akuzuarin J.H. duke mos e vërtetuar faktin e rëndësishëm të SMS-av ku me anë të tyre është vërtetuar se i akuzuari është nisur për Turqi, me dt. 26.01.2013 si dhe ilegalisht ka shkuar në Siri, po ashtu Prokuroria pretendon se në këtë çështje penale i pandehuri J.H. ka qenë së bashku edhe me të akuzuar të tjerë B.I., Z.B. Dhe H.N. të përfshirë në këtë grup terrorist mirëpo gjykata e shkallës së parë ka bërë veçim të procedurës, Prokuroria Speciale vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i mbështetur në dispozita ligjore, është i pa qartë i pa kuptueshëm, andaj konsiderojmë se me aktgjykimin me të cilin janë të akuzuar A.B., E.L., J.B., A.K., B.H., K.B. dhe B.H. duhet të ndryshohet, ndërsa sa i përket të akuzuarit J.H. gjykata duhet ta anuloj aktgjykimin dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe vendim.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.SH. av. G.H. në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi i atakuar është i pa kuptueshëm, tejet i mangët, në kundërshtim me vetveten si dhe me arsyetimin e tij, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë në mënyrë të duhur dhe të qartë vlerësimin e provave dhe deklarin e palëve në procedurë, për ta vërtetuar se a janë formuar elementet qenësore të veprës penale të Organizimit dhe pjesëmarrjes terroriste siç parashihet me dispozita ligjore, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të detajuar është dashur të vlerësoj saktësinë e provave kundërtënëse, për të vërtetuar se cila provë është kredibile për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësinë subjektive të pandehurit për këtë vepër, mbrojtja konsideron se gjykata në mënyrë shumë besnike dhe të plotë ia ka falur besimin Prokurorit të shtetit, dhe nuk e ka lejuar mbrojtësin e as të akuzuarin pavarësisht tentimit të tyre nuk i ka lejuar ta paraqesë gjendjen e vërtete dhe reale me të cilën do të kishte ndihmuar trupin gjykues të merr një vendim më të drejtë dhe në harmoni me ligjin, sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtja pretendon se Prokuroria e shtetit dhe gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta provoj fajësinë e të pandehurit, nga aktakuza e ngritur dhe gjate seancave gjyqësore u vërtetua se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale të Organizimit dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B., a.v. A.S. në ankesën e tij pretendon se është bërë shkelje në lidhje me shqiptimin e sanksionit penal, sepse gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese se i akuzuari është i moshës relativisht të re, e ka pranuar fajin në tersi, që nga dita e arrestimit, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale të tilla,

është pënduar thellë, andaj mbrojtja pretendon se dënimi prej 2 (dy) vite e 4(katër) muaj me burgim është tejet i lartë për te pandehurin.

Mbrojtësja e të akuzuarit E.L. av. N.H. në ankesën e saj pretendon se është bërë shkelje e dispozitave të procedurës penale se aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje esenciale, ku gjykata e shkallës së parë vendimin e sajë e bazon në deklaratën e të pandehurit të dhënë në procedurë paraprake, e fare pa e administruar si provë në shqyrtimin gjyqësorë, pra kjo do të thotë se aktgjykimi i ankimuar është i pa bazuar në prova të administruara, gjykata e shkallës së parë me këtë aktgjykim e ka shkelë edhe nenin 6 par. 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, po ashtu mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar asnjë provë me anë të se cilës ka vërtetuar identitetin objektiv dhe subjektiv të veprës penale, e as në arsyetim nuk ka cekë ndonjë fakt me të cilën është vërtetuar ekzistimi i veprës penale, mbrojtja i propozon Gjykatës se Apelit që të akuzuarit E.L. të ia zbutë dënimin.

Mbrojtësi i të akuzuarit J.B. av. A.I. me ankesën e tij pretendon në shkeljen e ligjit me rastin e shqiptimit të vendimit mbi sanksionin penal se aktgjykimi i cekur përkitazi me vendimin mbi dënimin, është i pa bazuar, i pa qartë sepse dënimi i shqiptuar është i ashpër dhe nuk qëndron në harmoni me rrethanat që i referohen ngjarjes kritike dhe që i përkasin kryesit, Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar vetëm rrethanat që janë veçanërisht lehtësuese ku për të pandehurin J.B. dënimi i shqiptuar në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 4 (katër) muaj është shumë i ashpër dhe nuk qëndron në proporcion me peshën e veprës penale, gjykata duhet të marrë parasysh edhe se i pandehuri ka pas një qëndrim korrekt, është duke studiuar, ka pranuar fajësinë etj.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.K. av. A.GJ. në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par 1.12, dhe aktgjykimi është i pa qartë i pa kuptueshëm dhe në kundërtënie me brendinë e tij. Në aktgjykim nuk janë paraqitur faktet vendimtare dhe aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 70 sepse nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe konkrete shkaqet për çdo pikë të aktgjykimit. Gjykata nuk tregon arsyetimin e sajë se i akuzuari në shqyrtimet gjyqësore njëjti e ka pranuar fajësinë apo është mbrojtur në heshtje, ndërsa dihet mirë fakti se i akuzuari A.K. e ka shfrytëzuar të drejtën për të mbrojtur në heshtje dhe në lidhje me këtë gjykata nuk jep asnjë vlerësim. Gjykata nuk vlerëson se kemi të bëjmë me dy raste dhe prokuroria nuk ka dhënë prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se i akuzuari i është bashkangjitur organizatës ISIS, e sipas ankesës edhe po të ishte paraqitur bëhet fjalë për tentativë për të shkuar në Siri e kjo nuk paraqet shkelje të ligjit nga se shkuarja si vizitor nuk është e ndaluar. Provat si transkriptet janë tepa besueshme sepse nuk vërtetohet se nga cili vend është biseduar dhe mungon hartografia e provave.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H. av. B.SH. në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është përfshirë në shkeljen e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2 nën par .2.1 e në lidhje me nenin 361 par . 1 të KPP-së, për arsye se gjykata e bazon aktgjykimin në deklaratën e dhënë në procedurë paraprake pa e administruar si provë. Ankesa pretendon se në rastet kur ekzistojnë vlerësimet dhe interpretimet e ndryshme atëherë duhet të interpretohen në favor të akuzuarit, nga se prezumimi i pafajësisë është element i çdo procesi të rregullt gjyqësorë. Ankesa pretendon se prova e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake nuk mund të përdoret si prova e drejtëpërdrejtë, duhet që ajo të përdoret si marrje në pyetje në mënyrë të tërthortë. Sipas ankesës Gjykata ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 262 për arsye se aktgjykimi është mbështetur vetëm në një provë edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për arsye se gjykata aktgjykimin duhet ta bazojë në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtim gjyqësorë dhe të njëjtat të vlerësojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Ndërsa aktgjykimi mbështetet vetëm në deklaratën e të akuzuarit, dhe faktet të cilat janë të dyshimta gjithmonë ato interpretohen në favor të akuzuarit, dhe aktgjykimi nuk është mbështetur

ne provat të cilat janë administruar ne shqyrtimin gjyqësor dhe si pasoj e kësaj është shkelur ligji penal ne dem te akuzuarit, sepse me asnjë prove nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i akuzuari e ka kryer veprën penale për te cilën është shpall fajtorë. Sa i përket sanksionit penal gjykata nuk e ka konfirmuar se a janë vërtetuar pretendimet se i akuzuari është fajtorë, gjykata nuk i ka vërtetuar ne mënyre te drejtë dhe të plotë mënyrën e matjes se dënimit edhe pse nuk janë gjetur rrethana renduese, dhe ankesa pretendon se të akuzuarit duhet ti zbutet dënimi.

Gjykata e Apelit, në pajtim me nenin 394 par.1 të KPP, duke e shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e PRSK-së dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, B.SH., A.B., E.L., J.B., A.K. dhe B.H. , e duke vepruar e sipas detyrës zyrtare nga neni 394 par. 1 të KPP, vlerësoj se aktgjykimi i ankimuar është i qartë i kuptueshëm, dhe nuk ekzistojnë kundërthënie në mes të dispozitiveve të aktgjykimit dhe arsyeve të paraqitura lidhur me faktet vendimtare për veprat penale për te cilat të akuzuarit e cekur me lartë janë shpallur fajtorë, si dhe për pjesën liruese me të cilën i akuzuari Jeton Halili në mungesë te provave ne bazë te nenit 364 par .1 nen par 1.3 të KPP është liruar nga akuza.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit për te akuzuarit, A.B. dhe J.B. të cilët kanë pranuar fajësinë për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par. 2 të KPRK, dhe i akuzuari B.H. i cili e ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja ne pronësi, kontrole, apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par .1 të KPRK, Gjykata e shkallës se parë drejtë ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bere ne pajtim me dispozitën e nenit 248 par. 1 nën par 1.1 gjer në 1.4 të KPP-së, kjo për faktin se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës të njëjtat e mbështetin faktet e çështjes në të cilat mbështetet aktakuza për veprat penale të cilat të akuzuarit e cekur më lartë kanë pranuar fajësinë.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore te mbrojtëseve të akuzuarve B.SH., A.K. dhe B.H. se aktgjykimi është përfshire në shkeljet esenciale të dispozitave te procedurës penale është i pa bazuar, kjo për arsye se dispozitivet e aktgjykimit për veprat penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par. 2 të KPRK, për te cilët të akuzuarit janë shpallur fajtorë, Gjykata e shkallës se parë ka dhënë arsye te qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare, e këto fakte vendimtare mbështeten nga vërtetimet mbi konfiskimin e armëve dhe municionit dhe foto dokumentacionit si dhe emrat e të akuzuarve për numrat e telefonave dhe CD për te akuzuarin A.K.n si prova materiale e si fakte vendimtare, se të akuzuarit e cekur me lartë kanë marrë pjesë dhe i janë bashkangjitur grupit terrorist ISIS të cilët përmes Aeroportit te Prishtinës kanë udhëtuar për ne Turqi dhe drejt kanë vijuar ne Siri, ku janë bashkangjitur, i akuzuari B.SH. ka qëndruar një muaj në Siri, i akuzuari E.L. ka qenë ne qytetin “ Hatal” e pastaj edhe ne “ Alepo” të Sirisë i është bashkangjitur fillimisht për tri javë grupit stërvitor “ MASKER”, për tu stërvitur për përdorimin e armëve e pastaj ka marrë pjesë edhe ne frontet e luftës, si dhe i akuzuari A.K. ne mënyre te njëjtë ka vepruar si të akuzuarit e tjerë ka shkuar ne Siri dhe i është bashkangjitur organizatës terroriste ISIS, dhe është kthyer përmes aeroportit të Tiranës, dhe i njëjti sërish pas kthimit ka provuar që të shkojë përsëri e ti bashkohet grupit terrorist mirëpo nuk i është lejuar hyrja ne Turqi dhe nga Stambolli është kthyer, edhe i akuzuari B.H. ka udhëtuar prej Prishtinës drejt Stambollit, ka shkuar drejt qyteteve “Askaraj” dhe “Rei Hanli” dhe ne mënyre ilegale është futur ne qytetin “Lataka” në Siri dhe i bashkëngjitet grupit të ISIS, ku kryen përgatitjet stërvitore e pastaj i merr edhe detyrat si ushtarë, edhe për pjesën liruese të aktgjykimit gjykata ka dhënë arsye te qarta dhe të plota, lidhur me faktet vendimtare, për të akuzuarin J.H., e kjo mbështetet në mospërputhjen me kohën e fluturimit nga SMK, dhe nuk mund të vërtetohet se i akuzuari J.H. a ka udhëtuar nga ANP Adem Jashari prej Prishtinës për ne Stamboll. Të gjitha këto fakte vendimtare mbështeten nga sistemi i menaxhimit të kufijve, nga konfirmimi i emalit zyrtar të kompanisë “ PEGASUS”, e duke marr parasysh se të akuzuarit nga provat materiale janë te armatosur dhe janë me uniforma dhe me armë te gjata, e të cilat uniforma me besueshmëri të lartë i takojnë organizatave terroriste të cilat veprojnë ne SIRI, e këto mbështeten edhe nga transkriptet

e komunikimit të cilin e kanë pas të akuzuarit B.SH., E.L. dhe nga transkriptet të cilat i ka pranuar i akuzuari A.K. prej bashkëshortes se saj e qe e vërteton faktin se aji ka qen pjesë e ISIS e cila ka vepruar ne Siri, e të gjitha këto transkripte i përgjigjen numrave te telefonave te cilët i kanë poseduar të akuzuarit. Në favor të përfundimit të këtyllë se të akuzuarit kanë marr pjesë ne Organizata Terroriste mbështetet ne raportin njoftues IDKT me shenjen 15 DKT- 2014, e të gjitha këto mbështeten me dëshmitë e dëshmitareve A.K. dhe A.O., të cilët vërtetojnë se janë bërë te gjitha ekzaminimet e pajisjeve elektronike të konfiskuara dhe pastaj është bërë nxjerrja e dëshmimeve dhe leximi i tyre, dhe nga sendet e sekuestruara si USB, Kompjuterët dhe telefonat celularë, dhe pas nxjerrjes se të dhënave janë nxjerr raportet dhe janë përpiluar të gjitha njoftimet e analizat lidhur me veprimtarin e të akuzuarve. Nga ajo që u tha më lartë sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit pretendimet ankimore se aktgjykimi është përfshire në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë, nga neni 384 par 1 nën par 1. 12 të KPP.

Pretendimet ankimore se gjendja faktike nuk është vërtetuar ne mënyre te drejt dhe te plotë është e pa bazuar, për arsye se aspak nuk është e kontestueshme se të akuzuarit B.SH., A.B., E.L., J.B., A.K. dhe B.H. përmes aeroportit Adem Jashari kanë udhëtuar për ne Turqi në Stamboll dhe pasi që kanë mbëri atje i akuzuari B.SH. ka vijuar drejt Sirisë dhe i është bashkangjitur ISIS si dhe i akuzuari A.B., E.L., J.B., B.H. dhe A.K. i cili edhe pas kthimit përsëri kanë tentuar që te shkojë ne Siri për të iu bashkangjitur rishtazi Organizatës terroriste ISIS mirëpo ishte kthyer mbrapa nga autoritete turke, gjykata drejt ka vërtetuar se te gjithë te akuzuarit janë stërvitur, dhe të gjithë me dashjen e tyre kanë shkuar dhe për te ju venë ne krah për te luftuar pranë Organizatës Terroriste ISIS e cila edhe me edhe nga ana e OKB-së janë shpallë si Organizata Terroriste, dhe të gjithë te akuzuarit kanë marrë pjesë aktive duke iu bashkangjitur organizatave terroriste. Për pjesën liruese të aktgjykimit për të akuzuarin J.H. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, gjykata drejt ka vërtetuar, se i akuzuari nga SMK dhe emailin zyrtarë, ka mospërputhje me kohën e fluturimit nga SMK, dhe gjykata drejt ka vërtetuar, se me një besueshmëri të lartë nuk është vërtetuar se i akuzuari J.H. a ka udhëtuar nga ANP Adem Jashari prej Prishtinës për ne Stamboll për te marrë pjesë në Organizatën Terroriste në ISIS.Kjo gjendje faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës se parë është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve B.SH., A.K. dhe B.H. se është shkelur nga neni 385 par. 1 të KPP, sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit pretendimet e këtylla ankimore nuk qëndrojnë dhe gjykata e shkallës se parë drejt ka aplikuar ligjin penal dhe ne asnjë mënyre nuk bëhet fjalë se ligji penal është aplikuar ne dem te akuzuarve, kjo për faktin e edhe nga KS i OKB, këto organizata janë shpall si terroriste, e të cilat janë ne përputhshmëri edhe me ligjin tonë penal dhe pretendimet ankimore se të akuzuarit kanë shkuar dhe kanë te drejtë lirshëm te shkojnë ne Siri për Gjykatën e Apelit nuk është kontestuese e drejta e tyre për te vizituar edhe Sirinë si vend ku ekziston konflikti i armatosur, mirëpo nga provat dhe shkresat e lëndës dhe nga deklarimi i vet të akuzuarve nuk rezulton se ata kanë pas për qellim te vizitojnë shtetin e Sirisë por qëllimi dhe dashja e tyre si është përshkruar edhe ne bazat tjera ankimore ka qenë se të akuzuarit ti bashkohen organizatave terroriste te cilat kanë vepruar dhe veprojnë edhe sot në Siri, e nga kjo del se gjykata e shkallës se parë drejt ka aplikuar ligjin penal dhe drejt ka vepruar që te akuzuarit i ka shpallë fajtor për veprat penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPRK-së. Edhe për pjesën liruese të aktgjykimit për të akuzuarin J.H. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK, pretendimet ankimore të PRSK janë te pa bazuara, për arsye se me asnjë provë gjykata nuk ka vërtetuar se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar dhe gjykata ka aplikuar drejtë ligjin penal që në mungesë të provave e në bazë te nenit 364 par 1 nën par 1.3 të KPP, të akuzuarin J.H. e ka liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit, duke i vlerësuar ankesat e PRSK dhe të mbrojtësve të akuzuarave, B.H., A.B., dhe J.B. janë të bazuara, dhe gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese, se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, dhe janë penduar për veprimet e tyre, se i akuzuari A.B. është i pa punë, ndërsa i akuzuari J.B. është student, se të akuzuarit J.B. dhe B.H. janë familjar, se asnjëri prej të akuzuarve gjer me tani nuk ka ra ndesh me ligjin, e kjo nënkupton se sjelljet e tyre të mëparshme kanë qene në harmoni me dispozitat pozitive të shoqërisë, e duke marrë parasysh edhe rrethanat tjera personale të tyre, Gjykata e Apelit në raport me të akuzuarit e cekur më lartë e ndryshoj aktgjykimin dhe ia zbuti dënimet, ashtu që të akuzuarve A.B. dhe J.B. ia shqiptoj dënimet me burgim në kohëzgjatje secilit veç e veç prej nga 2 (dy) vite e në të cilat dënime iu janë llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me dt. 09 .01.2015. ndërsa të akuzuarit B.H. ia shqiptoj dënimin me burgim ne kohëzgjatje 2 (dy) vite e 5(pesë) muaj e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe ne arrest shtëpiak prej dt. 18.08.2014 deri me dt. 02 .11.2015, ndërsa Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.SH., E.L. dhe A.K., ndërsa ka aprovuar ankesën e PRSK lidhur me vendimin mbi dënimin për te akuzuarit e cekur më lartë, kjo për faktin se gjykata nuk ka vlerësuar ne mënyre të duhur rrethanat rënduese duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe pasojat e saja në raport të rendit kushtetues të Republikës se Kosovës për mënyrën e ndaljes të veprimeve terroriste në raportet ndërkombëtare globale, e duke marrë parasysh edhe këmbëngulësinë e të akuzuarit A.K. për tu kthyer përsëri për të ju bashkangjitur organizatës terroriste ISIS si dhe pjesëmarrja aktive e të akuzuarve të cekur më lartë në luftë në krah të organizatës terroriste, gjykata i ashpërsoj dënimet për te akuzuarit E.L., dhe ia shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6(gjashtë) muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 11.08.2014 deri me dt. 09.01.2015, të akuzuarit A.K. për veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja ne grupe Terroriste nga neni 143 par .2 të KPRK ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6(gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim prej dt. 01.10.2014 deri me dt 15.07.2015, në arrest shtëpiak prej dt. 15.07.2015 deri me dt. 13.03.2016 si dhe paraburgimi prej dt. 30.05.2016 deri me dt.17.07.2018, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit dënimet e zbutura për te akuzuarit B.H., A.B. dhe J.B., dhe dënimet e ashpërsuara për te akuzuarit A.K. dhe E.L., janë ne përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve të cekur me lartë, dhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dënimet e këtilla të shqiptuara do të iu shërbejnë preventives individuale që të akuzuarit në të ardhmen të mos përsërisin vepra penale të këtilla apo tjera, si dhe preventivës së përgjithshme që dënimi i këtillë të ndikoj edhe te të tjerët në parandalimin e kryerjes së këtyre veprave penale, dhe pritet të arrihet edhe qëllimi i dënimin të paraparë si në nenin 41 të KPRK .

Si u cek edhe më lartë, u vendos si ne dispozitivët e këtij aktgjykimi e ne pajtim me dispozitat e nenit 401 dhe 403 PAR. 1 të KPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.585/2018, me dt.17.01.2019

Procesmbajtësi,

Eroll Gashi

Anëtarët e Kolegjit,

Fillim Skoro

Have Haliti

Kryetari i Kolegjit,

Tonka Berishaj

